



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 257/13 Prot

Tiranë, më, 30/06/2017

V E N D I M

Nr. 77, Datë 30/06/2017

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË ROSKOVEC DHE ISH KOMUNAT
KUMAN, KURJAN E STRUMË, "MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË,
RREGULLSHMËRISË, ADMINISTRIMIT FINANCIAR DHE VLERËSUES" PËR
PERIUdhËN PËR BASHKINË ROSKOVEC NGA 01.01.2013 DERI MË 31.12.2016 DHE
PËR TRE ISH KOMUNAT, KUMAN, KURJAN E STRUMË PËR PERIUdhËN
01.01.2013 – 31.07.2015.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare", të ushtruar në Bashkinë Roskovec për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2016 dhe për tre ish komunat, Kuman, Kurjan e Strumë për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015..

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

a) Bashkia Roskovec, administron pasuri nga ish Bashkia Roskovec, sipas listave të VKM nr. 770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall i lirë, me sipërfaqe totale **37 030 m²**, të cilat nuk shfrytëzohen dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pasuri të cilat në rast të vënies në përdorim nëpërmjet dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore, do të ishte në **vlerën 177,744,000 lekë**, efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore të Bashkisë Roskovec”.

b) Bashkia Roskovec, administron pasuri me vendndodhje në Njësinë Administrative Kurjan, nga ish Komuna Kurjan, sipas listave të VKM nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Kurjan, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall i lirë, me sipërfaqe totale **5147 m²**, të cilat nuk shfrytëzohen dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pasuri të cilat në rast të vënies në përdorim nëpërmjet dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, vetëm për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore, do të ishte në vlerën **24,705,600 lekë**, efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore të bashkisë Roskovec.

c) Bashkia Roskovec, administron pasuri me vendndodhje në Njësinë Administrative Strum, nga ish Komuna Strum, sipas listave të VKM nr. 241 datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Strum, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall i lirë, me sipërfaqe totale **1200 m²**, të cilat nuk shfrytëzohen dhe janë jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, pasuri të cilat në rast të vënies në përdorim nëpërmjet dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, vetëm për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore, do të ishte në vlerën prej **5,760,000 lekë**, efekti financiar i të ardhurave të munguara për njësinë vendore të bashkisë Roskovec.

d) Nga Bashkia Roskovec nuk është hapur regjistri kontabël i aktiveve në juridiksion të bashkisë, nga nëpunësi autorizues, Titullarja, Kryetare e Bashkisë, nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia, me të dhënat përkatëse për datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26, 27 dhe 30.

1.1. Rekomandim: Bashkia Roskovec të marrë masa që për asetet që ka në administrim si dhe për asetet e trashëguara nga ish Komunitat në juridiksion të saj, nëpërmjet strukturave të saj e sidomos zyra e Urbanistikës dhe zyra Juridike, të marrë masa:

a) për lidhjen e kontratave të qirasë me personat që kanë në përdorim objektet pronë e bashkisë dhe të kërkojë arkëtimin e detyrimeve nga momenti i lidhjes së kontratave të qirave;

b) për krijimin e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia me të dhënat përkatëse të çdo aktivi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Roskovec, nuk është vepruar për të aplikuar gjoba në vlerën e punimeve të kryera pa leje ndërtimi, subjekteve persona fizik dhe juridik, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 52, pika 1, germa "e", ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar", neni 5 germa "b" me efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, **në vlerën 19,000,000 lekë për 38 raste**, sipas Aneksit 11.1.

2.1. Rekomandim: Bashkia Roskovec, zyra e IMTV, të marrë masa për vendosjen e gjobave **në vlerën 19,000,000 lekë**, të subjekteve, sipas Aneksit 11.1, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

a) Nga bashkia Roskovec janë lëshuar Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi, **në 81 raste për sipërfaqe totale 90,79 ha tokë arë**, përkatësisht në vitin 2013 për 4 raste me sipërfaqe 7,26 ha, në vitin 2014 për 77 raste me sipërfaqe 83,53 ha, nga fondi i tokave bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, pasi këto toka bujqësore përfshihen në fondin e tokave disponibël shtetërore vënë në dispozicion nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në shkele të ligjit nr.8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pa ndara" neni 3, të ligjit nr. 57/2012, datë 17.05.2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore" neni 3 germa "b", të ligjit nr.8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore" neni 2, pika 5, germa "a", në shkelje të të Ligjit nr. 171/2014, datë 18.12.2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", nenin 2, pika 2, germa "b" paragrafi "vii" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.222, datë 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve".

3.1. Rekomandim:

a) Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të dërgojë shkresë ZVRPP Fier dhe ZQRPP Tiranë, për kufizimin e pronave tokë bujqësore të përfituara me AMTP për rastet sipas vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec përkatësisht me nr.21 datë 25.07.2013 dhe nr.12 datë 22.5.2014.

b) Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të dërgojë shkresë pranë Prefektit të Qarkut Fier për konfirmimin e ligjshmërisë ose paligjshmërisë nga Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë dhe të njoftohet Kontrolli i Latë i Shtetit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2012 deri 2016 nga drejtorët, përgjegjësit e inspektorët së zyrës së taksave janë nxjerrë listat e debitorëve dhe janë dërguar në zyrën e finances për t'u regjistruar si debitorë, por nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe

Drejtorisë së Taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe pikën 3 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe u rakorduan të dhënat për taksat e pa paguara; nga bizneset, taksa e tokës, qeraja e tokave shtetërore të pandara, taksat e popullatës, etj, periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2016, respektivisht për Bashkinë Roskovec dhe 3 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative, Kuman, Kurjan dhe Strumë duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Roskovec në vlerën **96,604,764 leke** (sipas Anekseve nga numri 1 deri 6 bashkëlidhur).

4.1 Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Roskovec të marrë masa për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012-deri më datën 31.12.2016 dhe pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve të taksave mungesë të ardhurash me dëm ekonomik, në vlerën **96,604,764 lekë**, respektivisht:

- në vlerën **2,477,403 lekë**, nga e cila vlera e qerasë për shumën 113,720 lekë dhe vlera e kamat vonesave të llogaritur për mos zbatimin e kushteve të kontratave të lidhur në masën 0.01% në ditë për vlerën 2,363,683 lekë.

- në vlerën **17,614,532 lekë**, nga mospagesa e 317 bizneseve detyrimet e taksave vendore; Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, Nga Drejtoria e Taksave të nxiren njoftim vlerësimit tatimore **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a-T’u ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-T’i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguajnë detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të llogariten kamat vonesat, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjorbë) bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014.

d-Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë Roskovec (Zyra e Taksave dhe Drejtoria Juridike) të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

e- Zyra e taksave në Bashkinë Roskovec dhe 3 Njësitë administrative, Kuman, Kurjan dhe Strumë të listojnë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masa për arkëtimin e taksave të tokës nga 3678 fermerë në vlerën **69,152,712 lekë** dhe taksën e popullatës në **vlerën 7,396,117 lekë**, gjithsejt për vlerën **76,548,829 lekë**. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifata etj.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 3 vjeçare 2013-2016 në Bashkinë Roskovec nuk janë realizuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, Bashkia Roskovec edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjiellës sh.a dhe për vitin 2016 kanë patur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, ndërkohë nuk ka mundur lidhjen e një marrëveshje, në të cilën Ujësjiellësi sh.a. Roskovec të përcaktohet si agjent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Roskovec.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjiellës sh.a. Roskovec, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në 5 investimet e audituara në bashkinë Roskovec, “Ndërtim trotuari i rrugës në fshatin Jagodinë”, “Ndriçim i rrugës së Kurjanit, Loti II”, “Ndërtim KUZ fshati Strumë”, “Rikonstruksion dhe shtesë e zyrave të Komunës Kuman” dhe “Rikonstruksion rruga Gjergji Goga dhe Komunale” me vlerë totale të kontratave 45,764,507 lekë pa t.v.sh nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në katër prej tyre në vlerën 1,515,000 lekë pa t.v.sh si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Roskovec u konstatua se gjatë viteve 2013 - 2016, kjo Bashki me territor zonë naftëmbajtëse dhe e pasur me burime e resurse natyrore të konsiderueshme, ka përfutuar të ardhura nga subjektet me aktivitete shfrytëzimin e resurseve, përdorimi i të cilave nuk është bërë transparent ndaj publikut dhe komunitetit, mangësi që ka sjellë edhe rritjen e numrit të ankesave.

7.1 Rekomandim: Bashkia Roskovec, të marrë masa në mënyrë të vazhdueshme dhe të bëjë transparente të ardhurat e fituara dhe përdorimin e tyre në funksion të plotësimit të nevojave të komunitetit, duke përdorur të gjitha format e komunikimit publik si: dëgjesa, sqarime në grup

apo individuale të kërkesa – ankesave, publikimin e buxhetit dhe të fondeve në median e folur dhe të shkruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Në mbështetje të shkronjës (a) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të neneve 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga ana e titullarit të njësisë audituar**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për kompensimin dhe shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 38,201,312 lekë, si më poshtë:**

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec, administron pasuri sipas listave të VKM nr. 770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall nën objekt dhe sipërfaqe funksionale, të objekteve të dhëna për strehim, me sipërfaqe totale **1000 m²**, të cilat shfrytëzohen nga personat të cilët kanë privatizuar objektin por jo truallin, pasuri të cilat duhej të arkëtohej qiraja për periudhën objekt auditimi sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, vetëm për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se **vlera 4,800,000 lekë**, me efekt financiar negativ, dëm ekonomik për njësinë vendore të bashkisë Roskovec, sipas Aneksit 9.1.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për lidhjen e kontratave të qirasë deri në privatizimin e truallit nën objekte e privatizuara dhe të ndjekë procedurat ligjore në të gjithë shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e **vlerës 4,800,000 lekë, sipas Aneksit 9.1.**

Deri më 31.12.2017

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Kurjan, ish komuna Kurjan, administron pasuri sipas listave të VKM nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Kurjan, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall nën objekt dhe sipërfaqe funksionale, të objekteve të privatizuara, me sipërfaqe totale **2610 m²**, të cilat shfrytëzohen nga personat të cilët kanë blerë objektin por jo truallin, pasuri të cilat duhej të arkëtohej qiraja për periudhën objekt auditimi sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, vetëm për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se **vlera 12,528,000 lekë**, me efekt financiar negativ, dëm ekonomik për njësinë vendore të bashkisë Roskovec, njësia administrative Kurjan (ish Komuna Kurjan).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për lidhjen e kontratave të qirasë deri në

privatizimin e truallit nën objekte e privatizuara, njësia administrative Kurjan, ish Komuna Kurjan dhe të ndjekë procedurat ligjore në të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtimin e **vlerës 12,528,000 lekë**, sipas Aneksit 9.2.

Deri më 31.12.2017

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Strum, ish komuna Strum, administron pasuri sipas listave të VKM nr.241 datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Strum, të Qarkut të Fierit”, të llojit tokë truall nën objekt dhe sipërfaqe funksionale, të objekteve të privatizuara, me sipërfaqe totale **2,100 m²**, të cilat shfrytëzohen nga personat të cilët kanë blerë objektin por jo truallin, pasuri të cilat duhej të arkëtohej qiraja për periudhën objekt auditimi sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.2.2014, mund të gjeneronin të ardhura për bashkinë, vetëm për periudhën e audituar (48 muaj), referuar çmimit minimal të dhënies me qira, rezulton se **vlera 10,080,000 lekë**, me efekt financiar negativ, dëm ekonomik për njësinë vendore të bashkisë Roskovec, njësia administrative Strum (ish Komuna Strum), sipas Aneksit nr.9.3.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për lidhjen e kontratave të qirasë deri në privatizimin e truallit nën objekte e privatizuara, Njësia Administrative Strum, ish komuna Strum, dhe të ndjekë procedurat ligjore në të gjithë shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **10,080,000 lekë**, sipas Aneksit 9.3.

Deri më 31.12.2017

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndriçim i rrugës së Kurjanit, Loti II*” Roskovec, me vlerë të kontratës 2,208,150 lekë pa tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **161,200 lekë pa t.v.sh** si pasojë e përfshirjes në situacion të t.v.sh së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. – prot., datë 21.12.2016 të lidhur mes Titullarit të AK Bashkia Roskovec dhe OE “S...” sh.p.k, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “a”, paragrafi i fundit, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8 si dhe UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **161,200 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “S...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. – prot., datë 21.12.2016 me objekt “*Ndriçim i rrugës së Kurjanit, Loti II*”, Roskovec, me vlerë të kontratës 2,208,150 lekë pa tvsh. Vlera prej **161,200 lekë pa t.v.sh** përfaqëson dëm ekonomik si rrjedhojë e përfshirjes së tvsh në situacionin

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim KUZ fshati Strumë*”, Roskovec, me vlerë të kontratës 14,503,314 lekë pa tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **547,200 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2250 prot., datë 07.09.2016 të lidhur mes AK Bashkia Roskovec dhe BOE “G...” sh.p.k dhe “D...” sh.p.k.

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **547,200 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik “G...” sh.p.k dhe “D...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 2250 prot., datë 07.09.2016 me objekt “Ndërtim KUZ fshati Strumë”, Roskovec me vlerë të kontratës 14,503,314 lekë pa tvsh. Vlera **547,200 lekë pa t.v.sh** përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion dhe shtesë e zyrave të Komunës Kuman”, me vlerë të kontratës 23,699,710 lekë pa tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **497,000 lekë pa t.v.sh** si pasojë e përfshirjes në situacion të t.v.sh së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 252/15 datë 17.07.2013 të lidhur mes ish – Titullarit të AK Komuna Kuman dhe OE “K...” sh.p.k, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “a”, paragrafi i fundit, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8 si dhe UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **497,000 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “K...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 252/15 datë 17.07.2013 me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë e zyrave të Komunës Kuman”, me vlerë të kontratës 23,699,710 lekë pa tvsh. Vlera **497,000 lekë pa t.v.sh** përfaqëson dëm ekonomik si rrjedhojë e përfshirjes së tvsh – së pajisjeve dhe makinerive në situacionin përfundimtar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion rruga Gjergji Goga dhe Komunale”, Roskovec, me vlerë të kontratës 9,702,983 lekë pa tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **309,600 lekë pa t.v.sh** si pasojë e përfshirjes në situacion të t.v.sh së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. – prot datë 19.11.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE “S...” sh.p.k, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8 si dhe UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **309,600 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “S...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. – prot datë 19.11.2015 me objekt “Rikonstruksion rruga Gjergji Goga dhe Komunale”, me vlerë të kontratës 9,702,983 lekë pa tvsh. Vlera **309,600 lekë pa t.v.sh** përfaqëson dëm ekonomik si rrjedhojë e përfshirjes së tvsh – së pajisjeve në situacionin përfundimtar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec*”, me fond limit 11,458,326 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, rezultoi se BOE i shpallur fitues “A...” shpk, “E... & Co” shpk “A...” shpk, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “a”, paragrafi i fundit, ka kontraktuar me vlerën ku është përfshirë 3% fond rezervë për makineri e pasije në shumën **76,674 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik të arkëueshëm nga subjekti.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **76,674 lekë**, nga BOE i shpallur fitues.

Menjëherë.

9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht*”, me fond limit 11,352,810 lekë, ku marrin pjesë 6 OE dhe janë s`kualifikuar 5, rezultoi se janë vendosur kritere në kundërshtim me aktet ligjore të LPP, në lidhje me kategoritë e licensës, ku dy kategori të licensës së punimeve të ndërtimit janë më të larta se volumi i punimeve dhe 6 kategori nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit. Është kërkuar në mënyrë të paargumentuar kërkesa për certifikatë titullin “*Specialist per testimin e performances se produkteve te ndertimit*, me ligjin nr.8402, date 10.9.1998, i ndryshuar, “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, nuk është argumentuar me volume e grafik punimesh numri i punonjësve. Në zhvillimin e procedurës së prokurimit rezultoi se nga KVO, 4 operatorë ekonomikë janë s`kualifikuar për kërkesa të padrejta të përcaktuara nga NJHDT. Nga auditimi i OE “A...” shpk të shpallur fitues rezultoi se nuk plotëson numrin e punonjësve si BOE. Në lidhje me s`kualifikimin e padrejtë të OE “Sh...” shpk me vlerë më të ulët të ofertës, 9,361,413 lekë të s`kualifikuar nga KVO për kritere të pasakta e të pa argumentura, të përcaktuara nga NJHDT, si i mungojnë: dokumenta që vërteton se një drejtues i shoqërisë të jete i certifikuar me titullin specialist për testimin e performancës dhe dokumente për kualifikimin e 7 punonjësve, është shkaktuar efekt me impakt negativ me pasojë dëm ekonomik në shumën e diferencës së dy ofertave: **1,292,186 lekë**, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga S.C. E.T. e A.D.

9.1 **Rekomandimi:** Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,292,186 lekë** të ndarë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e KVO S.C. E.T. dhe A.D.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1*”, me fond limit 9,395,476 lekë, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 3 rezultoi se është përlogaritur në fondin limit vlera e mbikqyrjes së punimeve në shumën 176,964 lekë, shumë e cila e ka rritur fiktivisht vlerën e kontratës dhe veprim në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Në këtë përlogaritje është vënë shënimi (i cili është publikuar edhe në DST në faqen e app.gov.al), sa vijon: “Disa punime të parashikuara në analizat e çmimeve nr 7; 8 dhe 9; 10 janë dhënë të peraferta, në analogji me punime për objekte të ngjashme të kryera me parë. Saktësimi i tyre do të bëhet gjatë zbatimit të punimeve në pershtatje me kushtet e krijuara dhe tipin e pompave që do sigurohen si dhe në funksion të kërkesave të tjera të bera posaçërisht (shih shenimet përkatëse në projekte dhe në fund të çdo analize), në kundërshtim ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 18. OE si rezultat i vendosjes në mënyrë të gabuar në fondin limit të vlerës prej 176,964 lekë për mbikqyrje punimesh si dhe diferenca e ofertës fituese është nga fondi limit është 152,150 lekë

rezulton se ka fituar këtë procedurë për më shumë se fondi limit për 176,964 lekë – 152,150 lekë = 24,814 lekë + (24,814 lekë x 20% tvsh) = **29,777 lekë dëm ekonomik** nga ofertimi mbi fondin limit, të arkëtueshëm nga subjekti “Sh...” shpk.

10.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **29,777** nga kontraktori “Sh...” shpk.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në tenderin i zhvilluar me objekt “*Projekti zhvillimor i qendrës Kuman*”, me fond limit 25,456,929 lekë, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 3 rezultoi se: Nuk janë bashkëlidhur analizat e cmimeve të punimeve të cilët nuk janë në manual. Në këtë preventiv i cili është bërë pjesë e dokumenteve të tenderit të sistemin e app, është përlllogaritur zëri “shpronësime” për $200 \text{ m}^2 \times 370 \text{ lekë/m}^2 = 74.000 \text{ lekë} + 74.000 \text{ lekë} \times 20\% \text{ tvsh} = \mathbf{88,800 \text{ lekë}}$. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim rezultoi se janë kërkuar 2 kategori license që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, është kërkuar arkitekt, ndërkohë autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”, janë kërkuar mjete mbrojtëse, e cila është kërkesë e sigurisë në kantier, BOE nuk i plotëson kriteret e kualifikimit dhe nuk duhej të ishte shpallur fitues.

Nga ana e KVO është bërë vlerësim me dy standarte pasi OE i shpallur fitues “A...” shpk nuk i plotëson kriteret e tenderit, sa sipërcituar.

Dëmi ekonomik i shkaktuar nga diferenca e dy ofertave = **1,088,560 lekë**, për të cilën mban përgjegjësi KVO i përbërë nga *S.C. E.T. dhe A.D.*

11.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,088,560 lekë** të ndarë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e KVO *S.C. E.T. dhe A.D.*

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në tenderin i zhvilluar me objekt “*Projekti zhvillimor i qendrës Kuman*”, me fond limit 25,456,929 lekë, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 3 rezultoi se: në preventiv, i cili është bërë pjesë e dokumenteve të tenderit të sistemin e app, është përlllogaritur zëri “shpronësime” për $200 \text{ m}^2 \times 370 \text{ lekë/m}^2 = 74.000 \text{ lekë} + 74.000 \text{ lekë} \times 20\% \text{ tvsh} = \mathbf{88,800 \text{ lekë}}$. Nga auditimi i preventivit të shpallur fitues e të kontraktuar rezulton se ky OE ka ofertuar për shpronësime si edhe për tvsh të paisjeve në shumën sa vijon: Shuma e shpronësimeve **2,600,000 lekë + 520,000 lekë (20% tvsh) = 3,120,000 lekë dëm ekonomik**.

12.1 Rekomandim: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,208,800 lekë** nga kontraktori “A...” shpk.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës për zbatimin e procedurave të blerjeve me blerje të vogla dhe likuidimin e tyre, në ish Komunën Kuman, bazuar në VKM nr.1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, rezultoi se me Urdhër Shpenzimi nr.166, datë 10.07.2014, me objekt ndërtim tombino në shumën 295,440 lekë me tvsh, për llogari të “S.S” sh.p.k, rezultoi se nuk disponohet skicë e cila të justifikojë se si kanë dalë volumet e punimeve si dhe të specifikohet se në cilat kanale janë kryer këto punime, nga ku vlera prej **295,440 lekë** është e pa argumentuar dhe përbën dëm ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, cka ngarkon me përgjegjësi P/ Zyrës të urbanistikës R.H. njëkohësisht edhe në cilësinë e preventivuesit, P.F. në cilësinë e ish P/Financës.

13.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **295,440 lekë** në mënyrë të barabarte nga R.H. dhe P.F. për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.166, datë 10.07.2014, me objekt likuidimi ndërtim tombino në shumën 295,440 lekë me tvsh.

Menjëherë.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës për zbatimin e procedurave të blerjeve me blerje të vogla dhe likuidimin e tyre, në ish Komunën Strum, bazuar në VKM nr.1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, rezultuan mangësi në likuidimet e kryera me urdhër shpenzimet sa vijon:

- Urdhër Shpenzimi nr.81,datë 17.06.2013 në shumën 192,000 lekë, punime situacioni (tombino φ 600) për llogari të “2...” sh.p.k. Nga auditimi rezultoi se nuk disponohej një skicë e mirfilltë e cila të përcaktoj se ku do të kryhen këto punime, nuk janë bërë hyrje në magazinë, vlera prej **192,000 lekë** përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe ngarkohen me përgjegjësi J.H. në cilësinë e preventivuesit, Y.A. në cilësinë e ish Magazinierit

- Urdhër Shpenzimi nr.158, datë 16.12.2013, blerje tombino φ 600, në shumën 253,200lekë për llogari të “S...” sh.p.k. Nga auditimi I ushtruar rezultoi se në urdhërin e prokurimit nuk specifikohet vëndi I saktë për kryerjen e prokurimit, nuk ka një skic apo planimetri e cila të vërtetoj se ku do të kryhen këto punime, sa më sipër shpenzimi i kryer prej **253,200 lekë përbën** dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi preventivuesin J.H.

- Urdhër Shpenzimi nr.184,datë 14.07.2014, në shumën 298,800lekë, punime situacioni për llogari të “2...” shpk. Nga auditimi I kryer rezultoi se në urdhrin e prokurimit specifikohet gërmim dheu me krah, sa më sipër kriteret e vendosura prej AK në lidhje me disponimin e dokumentacionit, pasjen e 1 skrepi, 1 pomp uji nuk kanë lidhje me objektin, nga ana tjetër mjetet e sipërcituara nuk faktohen me dokumentacion përkatës bashkangjitur urdhër shpenzimit, nuk disponohet një skic apo planimetri e objektit ku do të kryhen punimet. Sa më sipër vlera prej **298,800 lekë** është e pa justifikuar dhe përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, dhe ngarkohen me përgjegjësi R.T. në cilësinë e preventivuesit si dhe komisioni i blerjeve të vogla i përbërë nga A.B. njëkohësisht edhe në cilësinë e ish P/Financës, A.T. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve të Vogla dhe J.H. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve të Vogla. **4.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **744,000 lekë**, sa vijon:

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **192,000 lekë** në mënyrë të barabarte nga S.R. J.H. në cilësinë e preventivuesit, Y.A. në cilësinë e ish Magazinierit, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr. 81,datë 17.06.2013 në shumën 192,000 lekë, me object punime situacioni (tombino φ 600).

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **253,200 lekë** në mënyrë të barabarte nga J.H. në cilësinë e preventivuesit, Y.A në cilësinë e ish Magazinierit, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.158, datë 16.12.2013, me object likuidimi blerje tombino φ 600, në shumën 253,200 lekë

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **298,800 lekë** në mënyrë të barabarte nga R.T. në cilësinë e preventivuesit si dhe komisioni i blerjeve të vogla i përbërë nga A.B. njëkohësisht edhe në cilësinë e ish P/Financës, A.T. në

cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve të Vogla dhe J.H. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve të Vogla, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.184,datë 14.07.2014, në shumën 298,800 lekë, punime ndërtimi me situacion.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës për zbatimin e procedurave të blerjeve me blerje të vogla dhe likuidimin e tyre, në Bashkinë Roskovec, bazuar në VKM nr.1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, rezultuan mangësi në likuidimet e kryera me urdhër shpenzimet sa vijon:

- Urdhër Shpenzimi nr.191,datë 11.11.2013, pastrim kanalesh, në shumën 392,052 lekë pa tvsh, për llogari të J.Ll. PF. Nga auditimi rezultoi se nuk disponohet një planimetri apo skic se ku do të kryhen këto punime, nuk disponohet një preventiv i mirfilltë i cili të përcaktojë se si kanë dal volumet e punimeve, nuk disponohet akt marrje në dorëzim. Sa më sipër vlera prej **392,052 lekë** pa tvsh, është shpenzim i pa argumentuar me pasojë dëm ekonomik, sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi preventivuesja F.F. përgjegjësi i shërbimeve P.A. si dhe L.H. në cilësinë e ish Drejtoreshës së Financës.

- Urdhër Shpenzimi nr.209,datë 05.06.2015, pastrim kanalesh, në shumën 118,008 lekë, për llogari të “2...” sh.p.k. Nga auditimi rezultoi se nuk disponohet një planimetri apo skic e cila të justifikoj volumet e punimeve, gjithashtu nuk përcaktohet se ku do të kryhen këto punime, nuk ka akt-marrje në dorëzim të punimeve të kryera. Sa më sipër vlera prej **118,008 lekë** me tvsh është shpenzim i pa justifikuar dhe përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe ngarkohet me përgjegjësi L.H. në cilësinë e ish Dr/Financës, P.A. në cilësinë e ish P/Shërbimeve

- Urdhër Shpenzimi nr.92,datë 01.04.2015, kamera vëzhgimi, në shumën 98,900lekë, për llogari të O.V. Nga auditimi i kryer rezultoi se pajisjet e blera nuk kanë specifikime teknike të cilat të justifikojnë shpenzimin e kryer, nuk është bërë hyrje në magazinë, nuk disponohet garanci prej operatorit fitues. Sa më sipër vlera prej **98,000 lekë** pa tvsh është e pa justifikuar dhe përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, dhe ngarkohet me përgjegjësi përgjegjësjë e financës L.H. P.A. në cilësinë e ish P/Shërbimeve.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **608,060** lekë sa vijon:

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **392,052 lekë** nga preventivuesja F.F. përgjegjësi i shërbimeve P.A. si dhe L.H. në cilësinë e ish Drejtoreshës së Financës, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.191,datë 11.11.2013, pastrim kanalesh, në shumën 392,052 lekë pa tvsh.

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej 118,008 **lekë** nga L.H. në cilësinë e ish Dr/Financës, P.A. në cilësinë e ish P/Shërbimeve, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.209,datë 05.06.2015, me objekt likuidimi pastrim kanalesh, në shumën 118,008 lekë.

- Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës prej **98,000 lekë** përgjegjësjë e financës L.H. P.A. në cilësinë e ish P/Shërbimeve, për shkeljet e konstatuara sipas dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr.92, datë 01.04.2015, me objekt likuidimi kamera vëzhgimi.

Menjëherë.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Roskovec rezulton se në listë pagesat mbi shpërblimin e këshilltarëve të këshillit bashkiak dhe të ish komunave, këshilltarët janë paguar

edhe për ditë që nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje për periudhën objekt kontrolli, veprim në pajtueshmëri me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, për 92 këshilltarë, në shumën **1,934,815 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë dhe të ish Komunave, si më poshtë:

- Bashkia Roskovec për 30 persona në shumën **841,720 lekë**;
- Njësia Administrative Strum (ish Komuna Strum), për 15 këshilltarë në shumën **208,625 lekë**;
- Njësia Administrative Kurjan (ish Komuna Kurjan), për 16 këshilltarë në shumën 884,470 lekë;

16.1 Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat në vlerën **1,934,815 lekë** nga të gjithë këshilltarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit, sipas përcaktimeve të bëra në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe tabelave bashkëlidhur.

Brenda datës 31.12.2017

B/1. SHPENZIME NË FUSHËN E PROKURIMEVE, ME IMPAKT NEGATIV NË BUXHET:

1- Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Roskovec, u konstatua se në 4 procedura prokurimi, me vlerë totale 49,635,286 lekë, janë zhvilluar procedura prokurimi me kriteret të vecanta për kualifikim, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, janë s`kualifikuar e kualifikuar në mënyrë të gabuar OE pjesmarrës në garë, duke shkaktuar impakt negativ ekonomik prej **4,048,807 lekë**. Konkretisht në procedurat e prokurimit të zhvilluara me objekt:

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian”, me fond limit 13,577,240 lekë, marrin pjesë 5 OE dhe s`kualifikuar 4, të zhvilluar në vitin 2016, rezultoi se janë kërkuar kategori license me nivel më të lartë se vlera e punëve, janë kërkuar fuqi punëtore pa argumentuar me volume pune, është kërkuar kantier ndërtimi, në kundërshtim me VKM nr.312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier" dalë në zbatim, të neneve 8 dhe 18 të ligjit nr. 8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim", të ndryshuar, në specifikimet teknike është vendosur marka e materialeve , në kundërshtim me nenin 23, “Specifikimet teknike” të LPP, pika 5. Nga vendosja e gabuar e kriterëve të vecanta për kualifikim janë s`kualifikuar e kualifikuar në mënyrë të gabuar OE pjesmarrës në garë, duke shkaktuar impakt negativ ekonomik prej **1,063,630 lekë**, midis ofertës me vlerë më të ulët të s`kualifikuar për arësyen se nuk ka kantier ndërtimi dhe asaj me të lartë të kualifikuar që objekti me dokumentin e paraqitur i cili nuk mund të quhet kantier ndërtimi në funksion të objektit të prokurimit.

- “Ndërtim KUZ fshati Strum, Bashkia Roskovec”, me fond limit 15,055,516 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 6 OE dhe janë s`kualifikuar 5, rezultoi se janë vendosur kriteret të gabuara dhe jo në lidhje me objektin e prokurimit në lidhje me vërtetimin që nuk është debitor pranë Bashkisë Roskovec si dhe kërkesa për kategorinë për zbatim punimesh NS 12 –C (e cila nuk ka lidhje me objektin e prokurimit dhe në rast se po është e nivelit C) ka sjellë si pasojë s`kualifikimin e OE me vlerë më të ulët duke shkaktuar impakt negativ ekonomik për diferencën e ofertave në shumën **684,170 lekë**.

- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”, me fond limit 7,9 milion lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 7 OE dhe janë s`kualifikuar 6, rezultoi se në tre raste janë kërkuar kategori license me klasifikim më të lartë se volume I punimeve, janë kërkuar në tre raste kategori license që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, është kërkuar që një inxhinier të ketë certifikatë laborant materialesh ndërtimi, në kundërshtim me objektin e prokurimit. Në zhvillimin e procedurës rezultoi se nga vendosja e gabuar e kriterit të vecantë për kualifikim të vendosur nga NJHDT, shkak s`kualifikimi i OE me vlerë më të ulët, është shkaktuar efekt ekonomik me impakt negativ, në shumën e diferencës së ofertave **280,757 lekë**.

- “Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”, me fond limit 13,102,530 lekë, ku marrin pjesë 6 OE, dhe s`kualifikuar 2 rezultoi se është llogaritur më shumë fondi limit për 169,652 lekë. Në kundërshtim me nenin 23, “Specifikimet teknike” të LPP, pika 5, në dy raste është vendosur marka e produktit, janë kërkuar nivel të kategorisë së licensës më të lartë se volume i punimeve, për mjetet është kërkuar që ato të jenë në pronësi, duke mospërcaktuar formën e qiramarrjes në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pika 8, dhe është modifikuar kërkesa për largësinë e nyjes së inerteve në mënyrë të paargumentuar. Nga auditimi rezultoi se OE “S...” shpk, është s`kualifikuar nga gara për mosplotësim të kriterëve të vecanta për kualifikim, të përcaktuara nga NJHDT në mënyrë të paargumentuar dhe jo në lidhje me objektin e kontratës. Sa më sipër për kritere në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, të hartuara nga NJHDT, është s`kualifikuar OE “S...” shpk, duke u shkaktuar një impakt negativ ekonomik në shumën e diferencës së dy ofertave prej **2,020,250 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të vendosjes së kriterëve të vecanta për kualifikim jo në lidhje me objektin e prokurimit, për të eliminuar favorizimin e operatorëve ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlerë të vogël rezultuan përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 842,400 lekë, nga moszbatimi i kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht në dy rastet sa vijon:

- Me urdhër shpenzimi nr.23, datë 05.03.2015, me objekt prerje bimësh, në shumën 564,000 lekë rezultoi se nuk disponohet një skicë apo plan vendosje se ku kryen këto punime dhe se si ka dalë volumi i punimeve që do të kryhen. Gjithashtu referuar kontratës me nr.152/3 prot, datë 23.02.2015 rezultoi se objekti i kontratës është “Mirmbajtje kanali ujitës”, fakt i cili nuk ka lidhje me objektin në urdhërin e prokurimi i cili është prerje bimësh, nuk specifikohet numri i punojësve apo i mjeteve të cilët do të realizojnë këtë prokurim. Sa më sipër shpenzimi i kryer në shumën prej **564,000 lekë** përbën efekt negativ financiar.

- Me urdhër shpenzimi nr.59, datë 06.05.2014, me objekt ndërtim tombino në shumën **278,400** lekë rezultoi se nuk disponohet preventiv, nuk përcaktohet se ku do të kryhen këto punime, si dhe mungon skica përkatëse e cila të justifikojë volumet e punimeve të kryera, me pasojë mosjustifikimin me dokumentacion të shumës 278,400 lekë, shumë e cila përbën efekt negativ financiar ndaj buxhetit të shtetit.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për blerjet me vlerë të vogël, pa dokumentacionin argumentues e justifikues, preventiv, skica, planimetri, etj.

Menjëherë

C. MASA DISPLINORE:

C/I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 12 punonjësit e mëposhtëm:**

a) “Largim nga Shërbimi civil”

1- E.M. me detyrë Drejtore Juridike e Bashkisë Roskovec nga data 15.09.2009 e në vazhdim, në cilësinë e anëtares së NJHDT, pasi në në **15 procedura** prokurimi, sa vijon:

- “Ndricimi i rrugës Kuman Roskovec”
- “Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec”
- “Riparime në shkollat nën administrimin e Bashkisë Roskovec”
- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian”
- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”
- “Rikonstruksion i rrugës Dushk, NJA Kurjan”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Zona II”
- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”
- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Lulishte dhe park, rehabilitimi i fushës së “ish furri i bukës” Roskovec”
- “Ndërtim trotuari”
- “Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”

U konstatuan përcaktime të kërkesave të vecanta për kualifikim, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, neni 20 “Mosdiskriminimi” si dhe me nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, të cilat në 4 raste me pasojë impakt negativ ekonomik në buxhetin e bashkisë në shumën **4,048,807 lekë**.

2- M.C. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në Bashkinë Roskovec, nga data 16.03.2001 – 29.09.2015 dhe specialiste aktualisht finance, në cilësinë e anëtares se NJHDT, në **14 procedura** prokurimi:

- “Ndricimi i rrugës Kuman Roskovec”
- “Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec”
- “Riparime në shkollat nën administrimin e Bashkisë Roskovec”
- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian
- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”

- “Rikonstrukcion i rrugës Dushk, NJA Kurjan”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Zona II”
- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”
- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Lulishte dhe park, rehabilitimi i fushës së “ish furri i bukës” Roskovec”
- “Rikonstrukcioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”

U konstatuan përcaktime të kërkesave të vecanta për kualifikim, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, neni 20 “Mosdiskriminimi” si dhe me nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, të cilat në 4 raste me pasojë impakt negativ ekonomik në buxhetin e bashkisë në shumën **4,048,807 lekë**.

3- S.C. me detyrë Drejtor Ekonomik në Bashkinë Roskovec, nga data 27.08.2015 e në vazhdim, në cilësinë e Kryetarit të KVO, në **2 procedura** prokurimi:

- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht” ;
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”.

Për vlerësim të gabuar, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të DT, në dy procedurat e mësipërme të prokurimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë në shumën **2,380,746 lekë**.

4- A.D. me detyrë Drejtor i shërbimeve në bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura prokurimi:

- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht” ;
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”.

Për vlerësim të gabuar, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të DT, në dy procedurat e mësipërme të prokurimit, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë në shumën 2,380,746 lekë.

Shënim: *Për masat e mësipërme, Kryetari i Bashkisë, t'i vlerësojë në raport me shkeljet e konstatuara si dhe me burimet njerëzore që ka në dispozicion.*

b) “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”:

1- E.T. me detyrë specialist urbanistike dhe topograf në NJA Strum, pasi në procesverbalet e përlogaritjes së vlerës së kontratës nuk është përcaktuar bazueshmëria në manualin e analizave teknike të cmimeve, në kundërshtim ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 18. Nga auditimi në tre raste rezultuan rritje fiktive të fondit limit. Nuk janë bashkëlidhur analizat e cmimeve të punimeve, në specifikimet teknike të hartuara nga ky grup nuk është dhënë numri i punëtorëve, stafi drejtues e teknik, llojet e mjeteve, certifikatat ISO që duhen për realizimin e objektit, kjo në procedurat e prokurimit me objekt:

- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”

- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”.

2- B.M. me detyrë juriste në Drejtorinë juridike në Bashkinë Roskovec, pasi në procesverbalet e përlllogaritjes së vlerës së kontratës nuk është përcaktuar bazueshmëria në manualët e analizave teknike të cmimeve, në kundërshtim ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 18. Nga auditimi në tre raste rezultuan rritje fiktive të fondit limit. Nuk janë bashkëlidhur analizat e cmimeve të punimeve, në specifikimet teknike të hartuara nga ky grup nuk është dhënë numri i punëtorëve, stafi drejtues e teknik, llojet e mjeteve, certifikatat ISO që duhen për realizimin e objektit, kjo në procedurat e prokurimit me objekt:

- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”.

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Roskovec, që bazuar në shkeljet e trajtuara në këtë raport përfundimtar, të japë masa disiplinore:

C/I “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, neni 9 shkronja “b”, të kontratës individuale, për 6 punonjësit e mëposhtëm:

1. H.A. Administrator i Njesisë administrative Strumë

2. S.M. specialiste e taksave, Njësia Administrative Strumë

Për mos marjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, fakti që ende Njësia Administrative **Strumë** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likujduar të ardhura të munguara në vlerën **42,914,992** lekë, ose rreth 40% të totalit të debitorëve, **respektivisht**; 165 biznese nuk kanë paguar taksat vendore në vlerën 9,870,391 lekë, dhe 1097 Fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës për vlerën 33,044,601 lekë, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

3. D.Sh. me funksion Administrator i Njesisë administrative Kuman

4. R. Ç. Me funksion specialiste e taksave në Njësinë administrative Kuman

Për mos marjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, fakti që ende Njësia Administrative **Kuman** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likujduar të ardhura të munguara në vlerën **15,089,618** lekë , ose rreth 16 % të totalit të debitorëve **respektivisht**; 42 biznese në vlerën 1,325,103 lekë, 1048 Fermerë për taksën e tokës në vlerën 11,056,152 lekë, debitorë për ndërtesat në vlerën 1,544,960 lekë dhe 10 qeramarës debitorë për mos arkëtimin e qerave të papaguara në vite nga dhënia me qera 48.4 Ha toka të pandara në vlerën 1,163,403 lekë, nga e cila 113,720 lekë qera toke dhe 1,049,683 lekë kamat vonesa, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

5. P.T. me funksion Administrator i Njesisë Administrative Kurjan

6. D.G. me funksion specialiste e taksave në Njesisë Administrative Kurjan

Për mos marrjen e detyrës me proces verbal dhe pavarësisht punën që është bërë për arkëtimin e debitorëve, fakti që ende Njësia Administrative **Kurjan** deri më datën 30.04.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar të ardhura të munguara në vlerën **16,808,511** lekë, ose rreth 17 % të totalit të debitorëve, **respektivisht**; 28 biznese në vlerën 931,371 lekë, 548 Fermerë për taksën e tokës në vlerën 14,615,140 lekë, debitorë për ndërtesat në vlerën 1,262,000 lekë, në kundërshtim me udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”,

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **7 punonjësve** si më poshtë:

1- E.M. me detyrë Drejtore Juridike e Bashkisë Roskovec nga data 15.09.2009 e në vazhdim, në cilësinë e anëtares së NJHDT në **13 procedura** prokurimi, sa vijon:

- “Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec”
- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian”,
- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”
- “Rikonstruksion i rrugës Dushk, NJA Kurjan”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Zona II”
- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”,
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”
- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Lulishte dhe park, rehabilitimi i fushës së “ish furri i bukës” Roskovec”
- “Ndërtim trotuari”
- “Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”

2- M.C. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në Bashkinë Roskovec, nga data 16.03.2001 – 29.09.2015 dhe specialiste aktualisht finance, në cilësinë e anëtares se NJHDTt, në **12 procedura** prokurimi:

- “Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec”

- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian
- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”
- “Rikonstruksion i rrugës Dushk, NJA Kurjan”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Zona II”
- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”
- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Lulishte dhe park, rehabilitimi i fushës së “ish furri i bukës” Roskovec”
- “Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”

3- F.P. me detyrë ish përgjegjës i sektorit të ndërtimeve, në Bashkinë Roskovec, nga data 01.10.2015 – 31.03.2016, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në **5 procedura** prokurimi:

- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian
- “Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra”
- “Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”
- “Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”

4- E.K. me detyrë ish specialist topograf, në Bashkinë Roskovec, nga data 19.08.2015 – 31.12.2016, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në **6 procedura** prokurimi:

- “Ndricimi i rrugës Kuman Roskovec”
- “Rikonstruksion i rrugës Dushk, NJA Kurjan”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Zona II”
- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”

5- S.C. me detyrë Drejtor Ekonomik në Bashkinë Roskovec, nga data 27.08.2015 e në vazhdim, në cilësinë e Kryetarit të KVO, në **tre procedura** prokurimi:

- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”

6- E.T. me detyrë ish Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Roskovec, nga data 01.03.2016 – 07.01.2017, në cilësinë e anëtarit të KVO, në **tre procedura** prokurimi:

- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”

7- A.D. me detyrë Drejtor i shërbimeve në bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të KVO.

- “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht”
- “Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman”
- “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman”

➤ ***Në mënyrë të përmbledhur shkeljet, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, në këto procedura prokurimi janë:***

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec*” Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Rikonstruksion dhe ndërtimi i tualeteve brenda ambienteve shkollore, Bashkia Roskovec*”, me fond limit 11,458,326 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 3 OE dhe janë s`kualifikuar 2, u konstatua se fondi limit është përllëguar më tepër për 838,016 lekë. Në DT janë vendosur në 2 raste kërkesa, mbi ato të LPP. Në modifikimin e kërkesave të vecanta për kualifikim nuk është argumentuar shtimi I fuqisë punëtore nga 30 në 40 si dhe kërkesa për ekspert zjarfikës dhe për inxhinier me license laborator. Në këtë procedurë ka fituar vlera më e ulët e ofruar. OE i shpallur fitues, është shpallur fitues për më tepër **76,674** lekë, për fond rezervë 3% mbi makineri e paisje.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/ egjiptian*”, të zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 13,577,240 lekë, marrin pjesë 5 OE dhe s`kualifikuar 4, të zhvilluar në vitin 2016, rezultoi se janë kërkuar kategori license me nivel më të lartë se vlerë e punëve, janë kërkuar fuqi punëtore pa argumentuar me volume pune, është kërkuar kantier ndërtimi, në kundërshtim me VKM nr.312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier" dalë në zbatim, të neneve 8 dhe 18 të ligjit nr. 8402, date 10.9.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve në ndërtim", të ndryshuar, në specifikimet teknike është vendosur marka e materialeve, në kundërshtim me nenin 23, “Specifikimet teknike” të LPP, pika 5. Në zhvillimin e procedurës së prokurimit rezultoi se OE i shpallur fitues ka paraqitur nje inertesh për kantier. Nga vendosja e gabuar e kriterëve të vecanta për kualifikim janë s`kualifikuar e kualifikuar në mënyrë të gabuar OE pjesmarrës në garë, duke shkaktuar efekt ekonomik negativ prej **1,063,630** lekë, midis ofertës me vlerë më të ulët të s`kualifikuar se nuk ka kantier ndërtimi dhe asaj me të lartë të kualifikuar që objekti me dokumentin e paraqitur nuk mund të quhet kantier ndërtimi në funksion të objektit të prokurimit

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Rikonstruksion i shkollës Kuman, për tu përdorur për zyra*”, të zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 7,9 milion lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 7 OE dhe janë s`kualifikuar 6, rezultoi se në tre raste janë kërkuar kategori license me klasifikim më të lartë se volume i punimeve, janë kërkuar në tre raste kategori license që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, është kërkuar që një inxhinier të ketë certifikatë laborant materialeve ndërtimi, në kundërshtim me objektin e prokurimit. Në zhvillimin e procedurës rezultoi se nga vendosja e gabuar e kriterit të vecantë për kualifikim të vendosur nga NJHDT, shkak s`kualifikimi i OE me vlerë më të ulët, është shkaktuar efekt ekonomik me impakt negativ, në shumën e diferencës së ofertave **280,757** lekë.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës Dushk, NJA Kurjan*”, me fond limit 4,730,658 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 2 OE dhe janë s`kualifikuar 2, rezultoi se nuk janë argumentuar kërkesat në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga bashkia për mospasjë detyrimesh, janë kërkuar të gjitha llojet e mundëshme të kategorive të licensave, nga të cilat janë të pargumentuar, janë kërkuar paargumentuar me volume pune, makineri 43 lloje, specialist të profesioneve të ndryshme, janë kërkuar mjete mbrojtëse kërkesë e tejkualuar dhe detyrim ligjor I VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514,

datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, janë kërkuar certifikata ISO në tre raste pa lidhje me objektin e prokurimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c, dhe neni 20, “Mosdiskriminimi”, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, pasi nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT. Procedura e mësipërme është anuluar dhe është rihapur më datë 08.08.2016 dhe NJHDT ka vendosur po këto kërkesa, në kundërshtim me LPP. Në rihapjen e kësaj procedure ka marrë pjesë vetëm 1 OE i cili i ka plotësuar kriteret e tenderit.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Ndërtim KUZ fshati Strum, Bashkia Roskovec*”, me fond limit 15,055,516 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 6 OE dhe janë s`kualifikuar 5, rezultoi se janë vendosur kriteret të gabuara dhe jo në lidhje me objektin e prokurimit në lidhje me vërtetimin që nuk është debitor pranë Bashkisë Roskovec si dhe kërkesa për kategorinë për zbatim punimesh NS 12 –C (e cila nuk ka lidhje me objektin e prokurimit dhe në rast se po është e nivelit C) ka sjellë si pasojë s`kualifikimin e OE me vlerë më të ulët, duke shkaktuar efekt ekonomik negativ për diferencën e ofertave në shumën **684,170 lekë**.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmish*”, me fond limit 11,352,810 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 6 OE dhe janë s`kualifikuar 5, rezultoi se janë vendosur kriteret në kundërshtim me aktet ligjore të LPP, në lidhje me kategoritë e licensës, ku dy kategori janë më të larta se volume I punimeve dhe 6 kategori nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit. Është kërkuar në mënyrë të paargumentuar kërkesa për certifikatë titullin “Specialist për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit, me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, i ndryshuar, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nuk është argumentuar me volume e grafik punimesh numri i punonjësve. Në zhvillimin e procedurës së prokurimit rezultoi se KVO, 4 operatorët ekonomikë janë s`kualifikuar për kërkesa të padrejta të përcaktuara nga NJHDT. Nga auditimi I OE “A...” shpk të shpallur fitues rezultoi se nuk plotëson numrin e punonjësve si BOE, Në lidhje me s`kualifikimin e padrejtë të OE “Sh...” shpk me vlerë më të ulët të ofertës, 9,361,413 lekë të s`kualifikuar nga KVO për kriteret të pasakta e të pa argumentura, të përcaktuara nga NJHDT, si i mungojnë: dokumenta që vërtetoi se një drejtues i shoqërisë të jete të certifikuar me titullin specialist për testimin e performancës dhe dokumente për kualifikimin e 7 punonjësve; është shkaktuar dëm ekonomik në shumën e diferencës së dy ofertave: **1,292,186 lekë**.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan*”, me fond limit 123,571,989 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku merr pjesë 1 OE, rezultoi se janë vendosur kriteret në kundërshtim me aktet ligjore të LPP, në lidhje me vërtetimin që nuk është debitor në bashki, kategori të licensës ku 4 kategori nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, është kërkuar Liçence, për “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve”, leshuar nga QKL, frenon pjesmarrjen e OE në procedurën e prokurimit, pasi objekti i këtij tenderi nuk është për prodhim e tregëtim fidanësh si dhe volumet për këtë objekt sipas preventivit të përlogaritjes është 623,880 lekë, është kërkuar - “Liçence, për “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat” QKL”, nga ku rezultoi se objekti i prokurimit nuk ka lidhje me këtë kërkesë, nuk është argumentuar numri I fuqisë punëtore me volume e grafik punimesh, si

dhe kërkesa të shtuara për specialist e staf dhe certifikat ISO, “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISO 27001: 2005)”, që nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. Janë kërkuar 30 makineri e pajisje, ku 4 prej tyre nuk janë të argumentuara me volume punimesh. Mbas ankimit të kryer NJHDT ka shtuar kërkesa të tjera të paargumentuara. Në datën e hapjes së tenderit sipas procesverbalit datë 29.08.2016, rezultoi se ka marrë pjesë vetëm një OE “ F...” shpk, me vlerë të ofertës 119.863.242 lekë, i cili i plotëson kërkesat e vendosura nga NJHDT.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “*Ndërtim stacion pompimi – 2ST, fshati Suk 1*”, me fond limit 9,395,476 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 3 rezultoi se është përlogaritur në fondin limit vlera e mbikqyrjes së punimeve në shumën 176,964 lekë, shumë e cila e ka rritur fiktivisht vlerën e kontratës dhe veprim në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Në këtë përlogaritje është vënë shënimi (i cili është publikuar edhe në DST në faqen e app.gov.al), sa vijon: “Disa punime të parashikuara në analizat e çmimeve nr 7; 8 dhe 9; 10 janë dhënë të përafërta, në analogji me punime për objekte të ngjashme të kryera më parë. Saktësimi i tyre do të bëhet gjatë zbatimit të punimeve në pershtatje me kushtet e krijuara dhe tipin e pompave që do të sigurohen si dhe në funksion të kërkesave të tjera të bera posaçërisht (shih shenimet përkatëse në projekte dhe në fund të çdo analize), në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 18. Janë vendosur kritere për kategoritë e licensës ku 7 prej tyre nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, janë kërkuar punëtorë të specializuar e me dëshmi nga IQT të paargumentuara, është kërkuar pa lidhje me objektin e prokurimit certifikata ISO 27001:2013 Standart për Menaxhimin të Sigurisë së Informacionit. OE si rezultat i vendosjes në mënyrë të gabuar në fondin limit të vlerës prej 176,964 lekë për mbikqyrje punimesh si dhe diferenca e ofertës fituese është nga fondi limit është 152,150 lekë rezultoi se ka fituar këtë procedurë për më shumë se fondi limit për 176,964 lekë – 152,150 lekë = 24,814 lekë + (24,814 lekë x 20% tvsh) = **29,777** lekë dëm ekonomik nga ofertimi mbi fondin limit, të arkëtueshëm nga subjekti.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt “*Ndërtim KUZ fshati Kuman, Njësia Administrative Kuman*”, të zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 9.368.787 lekë, ku marrin pjesë 5 OE, dhe s`kualifikuar 4 rezultoi se nuk është kërkuar vërtetimi I xhiros së vitit 2015, nuk është argumentuar numri i punonjësve 40 të kërkuar, janë kërkuar tre punonjës me dëshmi IQT, në një kohë që këto dëshmi lëshohen edhe nga institucione të tjera. KVO ka përdorur dy standarte në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE, procedura duhej të anulohet, pasi asnjë nga OE në garë nuk është i vlefshëm, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, neni 1.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt “*Projekti zhvillimor i qendrës Kuman*”, me fond limit 25,456,929 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 4 rezultoi se: Nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve të punimeve të cilët nuk janë në manual. Në këtë preventiv i cili është bërë pjesë e dokumenteve të tenderit të sistemit e app, është përlogaritur zëri “shpronësime” për $200 \text{ m}^2 \times 370 \text{ lekë/m}^2 = 74.000 \text{ lekë} + 74.000 \text{ lekë} \times 20\% \text{ tvsh} = \mathbf{88,800 \text{ lekë}}$. Nga auditimi I kërkesave për kualifikim rezultoi se janë kërkuar 2 kategori license që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, është kërkuar arkitekt, ndërkohë autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”, janë kërkuar mjete mbrojtëse, e cila është kërkesë e sigurisë në kantier, BOE nuk i plotëson kriteret e kualifikimit dhe nuk duhej të ishte shpallur fitues. Nga ana e KVO është bërë vlerësim me dy standarte pasi OE i shpallur fitues “A...” shpk nuk i plotëson

kriteret e tenderit, sa sipërcituar. Efekti me impakt negativ me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar nga diferenca e dy ofertave = 1,088,560 lekë.

Nga auditimi i preventivit të shpallur fitues e të kontraktuar rezulton se ky OE ka ofertuar për shpronësime si edhe për tvsh të paisjeve në shumën sa vijon: Shuma e shpronësimeve 2,600,000 lekë + 520,000 lekë (20% tvsh) = 3,120,000 lekë dëm ekonomik.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt *“Ndricimi i rrugëve: Loti I, ndricim i rrugës Bushi Kola dhe Loti II – Ndricimi i rrugës së Kurjanit”*, me fond limit 4,924,921 lekë, të zhvilluar në vitin 2016, ku marrin pjesë 7 OE, dhe s`kualifikuar 1 rezultoi se është *llogaritur më shumë fondi limit për 62 copë x 4578 lekë/copë = 283,836 lekë*. Në kundërshtim me nenin 23, *“Specifikimet teknike”* të LPP, pika 5, në dy raste është vendosur marka e produktit. Janë vendosur kritere jo në përputhje me LPP, në lidhje me vërtetimin që nuk është debitor pranë Bashkië Roskovec, si dhe kërkesë për paraqitjen e mandat pagesës, është e pakuptimtë, kërkesë tej kritereve të përcaktuara në LPP, pasi AK që lëshon vërtetimet e mban vetë përgjegjësinë mbi vërtësinë e dokumentit. Në këtë procedurë për të dy lotet ka fituar vlera më e ulët e ofruar.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt *“Lulishte dhe park, rehabilitimi i fushës së “ish furri i bukës” Roskovec”*, me fond limit 2,840,366 lekë, me urdhër prokurimi nr.11, datë 06.10.2015, ku marrin pjesë 6 OE, dhe s`kualifikuar 3 rezultoi se janë vendosur kritere të gabara për kualifikim në lidhje me kategoritë e licensës, vërtetimi nga bashkia për mospasje detyrime ndaj saj. Në këtë procedurë ka fituar vlera më e ulët e ofruar.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt *“Ndërtim trotuari”* Urdhër prokurimi nr. 1, datë 17.02.2014 Në tenderin i zhvilluar me objekt *“Ndërtim trotuari”*, me fond limit 7,016,385 lekë, të zhvilluar në vitin 2014, ku marrin pjesë 3 OE, dhe s`kualifikuar 2, zhvilluar në vitin 2015, rezultoi se nuk është përcaktuar dokumentacioni për përvojën e ngjashme në sektorin privat, janë kërkuar gjashtë kategori license jashtë objektit të prokurimit, si dhe makineri të paargumentuara me volume pune. Pas ankimit në AK, është bërë modifikim I DT në mënyrë të paargumentuar për pakësimet dhe shtesat, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, pika, 3, *“Informacione të veçanta”*, nënpika a, *“Kontratat për punë”*. Në këtë procedurë ka fituar vlera më e ulët.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt *“Rikonstruksioni i rrugës “Gjergji Gora dhe rruga e komunales”* me fond limit 13,102,530 lekë, ku marrin pjesë 6 OE, dhe s`kualifikuar 2 rezultoi se është *llogaritur më shumë fondi limit për 169,652 lekë*. Në kundërshtim me nenin 23, *“Specifikimet teknike”* të LPP, pika 5, në dy raste është vendosur marka e produktit, janë kërkuar nivel të kategorisë së licensës më të lartë se volume i punimeve, për mjetet është kërkuar që ato të jenë në pronësi, duke mospërcaktuar formën e qiramarrjes në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 26, *“Kontratat për punë publike”*, pika 8, dhe është modifikuar kërkesa për largësinë e nyjes së inerteve në mënyrë të paargumentuar. Nga auditimi rezultoi se OE *“Spektri”* shpk, është s`kualifikuar nga gara për mosplotësim të kritereve të vecanta për kualifikim, të përcaktuara nga NJHDT në mënyrë të paargumentuar dhe jo në lidhje me objektin e kontratës. Sa më sipër për kritere në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, të hartuara nga NJHDT, është s`kualifikuar OE *“S...”* shpk, duke u shkaktuar një efekt me impakt negativ ekonomik në shumën e diferencës së dy ofertave prej **2,020,250 lekë**.

- Në tenderin i zhvilluar nga ish Komuna Kurjan me objekt *“Ndërtim i ujësjellësit Kurjan”* me fond limit 83,198,479 lekë, të zhvilluar në vitin 2013, ku marrin pjesë 4 OE, dhe s`kualifikuar 3, zhvilluar në vitin 2013, rezultoi se Në dosje nuk ndodhet preventivi që ka shërbyer si bazë për përlllogaritjen e fondit limit. Gjithashtu nuk ka asnjë dokumentacion mbi detyrën e projektimit,

analizat e cmimeve si dhe projektet, si dhe nuk ka dokumentacion nga projektuesi. Është kërkuar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pika, 3, “Informacione të veçanta”, nën-pika a, “Kontratat për punë”, kontrata të ngjashme dhe nuk është argumentuar numri i fuqisë punëtore me volume pune.

E . KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, bëjmë kallëzim penal për 7 personat si më poshtë:

- 1- **E.M.** me detyrë Drejtore Juridike e Bashkisë Roskovec nga data 15.09.2009 e në vazhdim, në cilësinë e anëtares së NJHDT, në **6 procedura** prokurimi, sa vijon:
- 2- **M.C.** me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në Bashkinë Roskovec, nga data 16.03.2001 – 29.09.2015 dhe specialiste aktualisht finance, në cilësinë e anëtares se NJHDT, në **6 procedura** prokurimi:
- 3- **E.K.** me detyrë ish specialist topograf, në Bashkinë Roskovec, nga data 19.08.2015 – 31.12.2016, në cilësinë e antëtarit të NJHDT, në **4 procedura** prokurimi:
- 4- **F.P.** me detyrë ish përgjegjës i sektorit të ndërtimeve, në Bashkinë Roskovec, nga data 01.10.2015 – 31.03.2016, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në **2 procedura** prokurimi:
- 5- **S.C.** me detyrë Drejtor Ekonomik në Bashkinë Roskovec, nga data 27.08.2015 e në vazhdim, në cilësinë e Kryetarit të KVO, në **2 procedura** prokurimi:
- 6- **E.T.** me detyrë ish Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Roskovec, nga data 01.03.2016 – 07.01.2017, në cilësinë e anëtarit të KVO, në **2 procedura** prokurimi:
- 7- **A.D.** me detyrë Drejtor i shërbimeve në bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të KVO, në **2 procedura** prokurimi:
 - “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Velmisht” ;
 - “Projekti zhvillimor i qendrës Kuman” .

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendor.

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ